



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA SHTIME



**ZYRA E PROKURIMIT**

Nr. 0311/1051

Datë 30/10/2020

**KONTRATË**

**( PUNË )**

**Komuna Shtime Rr., Tahir Sinani ,, tel. 0290-389-016-131, që e përfaqëson Drejtori i Prokurimit Muhadin Halili në njëren anë;**

dhe

**Grup i Operatorëve Ekonomik INTACT SH.P.K.; N.P.T. Bamirs, Prizren” që e përfaqëson I autorizuar I autorizuar Bledar Elshani nr I leternjoftimit I 170764133, tel. 044 473 653, ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:**

**Renovimi i Hapsirave të mbrendshme në Objektin e Qendrës Rinore**

Nr i prokururimit : 617-20-4767-5-2-1

Nr i brendshëm : 617-2020-059-521

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

**Renovimi i Hapsirave të mbrendshme në Objektin e Qendrës Rinore**

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë : 12,360.45 €

( Dymbëdhjetëmijë e treqindë e gjashtëdhjetë euro e katërdhjetë e pesë centi )

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e të Veçanta të kontratës, nr i brendshëm i prokurimit : 617-2020-059-521

**Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Marrëveshja e kontratës;

- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (f) (Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)
- (g) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 4 Komunikimet



4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikatë, ose vendim, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të lillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i lillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

#### Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Muhadin Halili
Pozita:	Drejtor i Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	30.09.2020
Vula:	

#### Për Kontraktuesin

Emri:	Bledar Eshani
Pozita:	I autorizuari
Nënshkrimi:	
Data:	30.09.2020
Vula:	

## **PJESA II E KONTRATES      KUSHTET E PËRGJITHSHME**

### **Neni 1              Përkufizimet**

1.1 “**Kontratë**” do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 “**Punë**” konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 “**Kontraktuesi**” është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 “**Menaxheri i Projektit**” është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës ( apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 “**Çmimi Kontratës**” do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 “**Vendi i ndërtimit**” do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 “**Pajisjet e kontraktuesit**” do të thotë o tërë makineria përfshirë edhe ato për bartjen e pajisjeve, dhe mjete të tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 “**Skicat**” nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat o siguruaru dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 “**KPK**” do të thotë Kushtet o Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “**KVK**” do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

### **Neni 2              Gjuha dhe ligji i aplikueshëm**

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

### **Neni 3              Transferimi**

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguresve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguresit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

### **Neni 4              Nën-kontraktimi**

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontrktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontrakon pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshme.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeht lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët .

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

### **Obligimet e Autoritetit Kontraktues**

#### **Neni 5 Dhënia e dokumenteve**

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet li kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

#### **Neni 6 Qasja në vend punishte**

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do t'i jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbaje çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, t'i kthej ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

#### **Neni 7 Ndhimja lidhur me rregulloret vendore**

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

### **Obligimet e Kontraktuesit**

#### **Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit**

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpallosë asnjë detaj të kontratës pa pajllim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skola të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rasti, objektet përreth, trafikut etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktivitetëve në vend punim.

## **Neni 9                    Personeli**

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

## **Neni 10                  Siguria e ekzekutimit**

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të **Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm**.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

## **Neni 11                  Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit**

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet **Certifikata e Korigjimit të Defekteve**, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrisë çmimin e shpërblyer nga fitimi i kontraktuesit.

## **Neni 12 Programi**

12.1 Brenda kohës së specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë së paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për mo topër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnojë Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rrisë detyrimet e kontraktuesit sipas periudhës të kontraktuarës, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punëve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

## **Neni 13 Siguria në vend punishte**

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndalojë qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skermën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave ose që me arsye mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues.

## **Neni 14 Ndërrhyrja me trafikun**

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rrugë ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë të veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marrë parasysh se ato kryhen në ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçantë që ai synon të ndër marrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

## **Neni 15 Tatimi**

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

#### **Neni 16 Kostoja e Riparimeve**

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

### **FILLIMI DHE VONESAT**

#### **Neni 17 Fillimi i punëve**

17.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajllim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

#### **Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit**

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet të do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca mëdhe të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do të lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

#### **Neni 19 Dëmet e likuiduara**

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të nenit 19.1 ai mundet, pasi ta njoftojë Kontraktuesin:

- (a) konfiskojë garancinë e realizimit; dhe / ose
- (b) të ndërpresë kontratën; dhe
- (c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e Kontraktuesit për ofrimin e bilancit të punimeve.

### **Materialet dhe mjeshtëritë**

#### **Neni 20 Regjistri i punës**

20.1 Një regjistër i punës do të, përveç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhëne Kontraktuesit;
- b) deklaratat e hollësishtme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bërë Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune në progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistrin. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marrë një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

#### **Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve**

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të jenë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit Kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të jenë objekt i një kërkesë të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet të referohet numrit të kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do të zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në punë.

21.3 Nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në punë ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikujt do të pranohen për inkorporim në punë vetëm nëse janë riparuar.

#### **Neni 22 Inspektimi dhe testimi**

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emërojë "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuase të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rena dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet të dorëzohen në kohë në vend për të lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do të lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë në përmbushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishte ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do të miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes së mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit

kontraktuesi i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë te Kontraktuesit. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

### **Neni 23 Paralajmërim i hershëm**

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bere të nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigojnë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

## **PAGESAT**

### **Neni 24 Pagesa**

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do t'i paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhet nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

### **Neni 25 Paramasa dhe Paralogaria**

25.1 Paramasa dhe paralogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe paralogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Paralogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbaj aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

### **Neni 26 Parapagimi**

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

#### **Neni 27 Mbajtja e Parasë**

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shume në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë të mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

#### **Neni 28 Vërtetimet e pagesës**

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a. Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Paralogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Paralogari që është përfunduar; ose
- b. Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

#### **Neni 29 Llogaritja përfundimtare**

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës së llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumën e cila sipas opinionit të tij duhet t'i paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

## **Neni 30 Shkaqet për kompensim**

30.1 Shkaqet për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbyshje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

## **PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET**

### **Neni 31 Parimet e përgjithshme**

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit

### **Neni 32 Testet për përfundimin**

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

### **Neni 33 Pranimi i përkohshëm**

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

#### **Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet**

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriç të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

#### **Neni 35 Pranimi përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimin përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare e pranimin dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

#### **Shkelja e kontratës dhe shkëputja**

##### **Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose

b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja,
- d. Pagosa o vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shikëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi su m'u shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.

v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

#### **Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit 39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

#### **Neni 40 Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Implantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

#### **Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

#### **Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përipiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### **Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

**PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10 % i vlerës së kontratës. OE, duhet të sjell sigurimin e ekzekutimit të punimeve për një periudhë deri më 21 01 2021 e pasaj do të nënshkruhet Kontrata
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impiantove dhe Materialeve</li> <li>2. humbje ose dëmtim i Pajisjeve</li> <li>3. humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve)</li> <li>4. dëmtim personal ose vdekje: <ol style="list-style-type: none"> <li>(i) të punëtorëve të Kontraktuesit</li> <li>(ii) të personave të tjerë</li> </ol> </li> </ol> <p><b>Përgjegjësi mbanë kontraktuesi (OE)</b></p>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë: <b>30.09.2020</b>
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha punëve do të jetë <b>15.12.2020</b>
Dëmet e likuiduara	19.1	<p>Dëmet e likuiduara për të gjitha punët në bazë të pozicioneve janë <b>0.25%</b> për ditë.</p> <p>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është <b>10%</b> e Çmimit final të Kontratës..</p>
Regjistri i punës	20.1	OE është i obliguar të mbaj regjistër të punës.

Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: Gazmend Hysenaj
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: <i>Nuk aplikohet</i>
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: <i>10% e vlerës së Kontratës</i>
Mënyra e pagesës	30.1	<p><b>Pagesa do të bëhet si në vijim: Pagesa do bëhet nga buxheti i vitit 2020 në bazë të situatave (Çertifikatave) për punët e kryera të verifikuara nga Menaxheri i kontratës.</b></p> <p>OE duhet të sjellë këto dokumente për pagesën e fundit :</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Garancioni për punët e kryera për( 12 muaj )</li> <li>2.Raporti i pranimit teknik nga komisioni.</li> <li>3.Situacioni përfundimtar .</li> <li>4.L'atura e rregullt.</li> <li>5.Raporti nga mbikqyrësi për përfundimin e punëve me plan dinamikë</li> </ol>
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	OE është i obliguar të sjellë një garancion bankar ose nga kompania e sigurimit të vlerës së 10% të kontratës për periudhen 12 mujore nga dita e pranimit teknik të projektit.
Pagesa shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<i>Palet kontraktuese do të bëjnë përpjekje për ti zgjidhur mosmarrveshjet eventuale , përmes mirëbesimit ose negociatave miqësore .</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet lënda në gjykatën Kompetente .

**PARAMASA DHE PARALLOGARIA**

**Rregullimi i hapësirave të brendëshme në Objektin e Qendres Rinore**

Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia matëse	Sasia	Çmimi	Total
-----	-------------------------	---------------	-------	-------	-------

Përshkrimi i punëve. Në përputhshmëri të plote me standardet EC dhe ISO.

Vërejtje: Pasi që demolimi dhe renovimi është paraparë të bëhet në pjesë të caktuara të objektit sipas projektit, gjatë demolimit dhe renovimit duhet të bëhet izolimi dhe kufizimi i zonës së caktuar për demolim dhe renovim në mënyrë që të mos pengohet mbarëvajtja funksionale e pjesës tjetër të objektit.

Gjate punëve të demolimit punëkryesi duhet të ketë kujdes që të mos demtoj pjesë tjera të cilat nuk janë parapare për demolim. Cdo demtim të parapare nga punëkryesi, obligohet që ta riparoj dhe ta kthejë në gjenjide fillestare.


Punëkryesi është i obliguar që pas përfundimit të punimeve të bëjë pastrimin e zonës, bartjen dhe transportin e materialit të panevojshëm deri në deponi të përcaktuar nga organi mbikqyres.

**A ARKITETURA**


**I PUNIMET E DEMOLIMIT**

1.1	Demolimi i derës nga materiali PVC. Materiali i demoluar duhet të transportohet nga objekti deri në deponi e caktuar nga organet kompetente deri në 10km.	cope	1	2.00	€	2.00
1.2	Demolimi i dritareve nga materiali PVC. Dritaret me dim. (210 x 115)cm me mbëndricim. Materiali i demoluar duhet të transportohet nga objekti deri në deponi e caktuar nga organet kompetente deri në 10km.	cope	14	0.50	€	7.00
1.3	Demolimi me kujdes i konstruksionit meskatesh të demtuar nga materiali i drurit, të parashihen skelet e nevojshme për kryerjen e punës. Materiali i demoluar duhet të transportohet nga objekti deri në deponi e caktuar nga organet kompetente deri në 10km.	m <sup>2</sup>	25	10.00	€	250.00
1.4	Geryerja e mureve të brendshme deri në bllok në pjesët ku ka lageshti. Materiali i demoluar duhet të transportohet nga objekti deri në deponi e caktuar nga organet kompetente deri në 10km.	m <sup>2</sup>	635	0.02	€	12.70
1.5	Demolimi i instalimeve elektrike, në të gjitha hapsirat që do të intervenohet. Materiali i demoluar duhet të transportohet nga objekti deri në deponi e caktuar nga organet kompetente deri në 10km.	m <sup>2</sup>	175	0.05	€	8.75
1.6	Demolimi i estrihut në vendet ku është demtuar si dhe transporti deri në deponi. Materiali i demoluar duhet të transportohet nga objekti deri në deponi e caktuar nga organet kompetente deri në 10km.	m <sup>2</sup>	175	0.10	€	17.50
	Demolimi i qeramikave në banjo duke përfshirë qeramikat në mure dhe dysheme. Materiali i demoluar duhet të transportohet nga objekti deri në deponi e caktuar nga organet kompetente deri në 10km.	m <sup>2</sup>	64	0.20	€	12.80
	Demolimi i instalimeve të ujeshjellsit neper banjo si dhe thyerja e betonit. Materiali i demoluar duhet të transportohet nga objekti deri në deponi e caktuar nga organet kompetente deri në 10km.	m <sup>2</sup>	16	0.05	€	0.80
	Demolimi i instalimeve të kanalizimit neper banjo si dhe thyerja e betonit. Materiali i demoluar duhet të transportohet nga objekti deri në deponi e caktuar nga organet kompetente deri në 10km.	m <sup>2</sup>	16	0.05	€	0.80
<b>I</b>	<b>TOTAL PUNIMET E DEMOLIMIT</b>				€	<b>312.35</b>


**II PUNIMET E KONSTRUKSIONI MESKATESH**



2.1	Furnizimi me material dhe punimi i konstruksionit meskatesh -dyshemes nga druri i thate i kualitetit te larte me kete permbajtje: - Trajet primare nga druri ~(25x45)cm te cilat duhet te fiksohen ne vrimat ekzistuese ne mure. - Trajet sekundare nga druri ~(18x16)cm qe vendosen ne menyre terthore me trajet primare ne distance nga njera tjetra cdo ~80cm. - Dyshemeja nga derrasat e drurit me trashesi t=5.5cm - Iver-pllaka te vendosura ne dyshem permbi derrasa. Dyshemeja e re duhet te jete ne te njejtin nivel me dyshemet ekzistuese. Ne cmim te kalkulohet te gjihe aksesoret e nevojshem per fiksimin e konstruksionit, ngjyrosja e drurit per mbrojtje nga ndikimet e jashtme etj.	m <sup>2</sup>	34	10.00	€	340.00
2.2	Furnizimi me material dhe montimi i tavanit nga pllakat e gips kartonit me trashesi 12mm. Ne cmimi te kalkulohet konstruksioni i nevojshem metalik, leshi mineral 100mm, rrejete me fuge dhe patinimi, ngjyrosja me ngjyre ne dy shtresa dhe te gjitha aksesoret e nevojshem per fiksimin e tavanit.	m <sup>2</sup>	34	10.00	€	340.00
2.3	Furnizimi me material dhe riparimi i kulmit te nga tjegullat, evidentimi i rrjedhjes se ujit dhe rregullimi i tije ne menyre qo te mos pikoje uji brenda. Ne cmim te kalkulohet nderrim i tjegullave te demtuara dhe fiksimi i ancoreve, ullukeve horizontal, llamarines se demtuar, kulmave, etj. Llogaria ne m2 te sip se rrafshite te komplet kulmit te rregulluar	m <sup>2</sup>	750	0.10	€	75.00
<b>II</b>	<b>TOTAL PUNIMET E KONSTRUKSIONI MESKATESH</b>				€	<b>755.00</b>
<b>III</b>	<b>PUNET E ZDRUKHTHARISE</b>					
3.1	Furnizimi transporti dhe montimi i dritares me dim. (150 x 115)cm nga profili i plastikës me trashësi t=8.3cm. Profilët dhe mekanizmi montues të jetë prodhim i vendeve të BE-së. Xhami i tipit THERMO /dopio/ 6+16+4 dhe te plotesojne standardet termike Kw deri ne K=1,8 W/m Te kompletohet me mekanizëm , bagllama dhe dorëz për hapje dhe mbyllje. Ngjyra dhe tekstura e dritares te jete PVC me tekstur te drurit dhe ngjyre te kaft. Verejtje: Masat per prodhim te merren ne vend! Llogaria ne cope.	cope	14.0	50.00	€	700.00
3.2	Furnizimi transporti dhe montimi i dritares me dim. (60 x 115)cm nga profili i plastikës me trashësi t=8.3cm. Profilët dhe mekanizmi montues të jetë prodhim i vendeve të BE-së. Xhami i tipit THERMO /dopio/ 6+16+4 dhe te plotesojne standardet termike Kw deri ne K=1,8 W/m Te kompletohet me mekanizëm , bagllama dhe dorëz për hapje dhe mbyllje. Ngjyra dhe tekstura e krahut te dritares te jete PVC me tekstur te drurit dhe ngjyre te kaft. Verejtje: Masat per prodhim te merren ne vend! Llogaria ne cope.	cope	14.0	25.00	€	350.00



3.3	Furnizimi transporti dhe montimi i deres me dim. (100 x 210)cm nga profili i plastikës me trashësi $t=8,3$ cm. Profilët dhe mekanizmi montues të jetë prodhim i vendeve të BE-së. Xhami i tipit THERMO /dopio/ 6+16+4 dhe te plotesojne standardet termike Kw deri ne $K=1,8$ W/m Te kompletohet me mekanizëm , bagllama dhe dorëz për hapje dhe mbyllje. Ngjyra dhe tekstura e krahut te deres te jete PVC me tekstur te drurit dhe ngjyre te kafc. Verejtje: Masat per prodhim te merren ne vend! Llogaria ne cope.	cope	3.0	90.00	€	270.00	
3.4	Furnizimi me material dhe vendosja e dyerve nga druri me dim. (90/210)cm -Krahu i derës me trashësi 40mm Materiali: Dru i kualitetit të lartë kategoria A1 Mbushja: Fije minerale MAT, e tërë sipërfaqja e mbuluar me ngjites, izolimi termik bazuar ne rreguloren DIN 52619 ( $UT=1.3$ W / m <sup>2</sup> K), korniza standarde Dru 15-30 mm, shtresë standarde e bërë me super dekor, Super-Color, Super-Multi Color. Te Kompletohet me dorezë alumini me pllakëz për objekte publike dhe bagllama standarde për objekte publike. Verejtje: Masat per prodhim te merren ne vend!	cope	2.0	220.00	€	440.00	
3.5	Furnizimi me material dhe vendosja e dyerve nga druri me dim (80/210)cm -Krahu i derës me trashësi 40mm Materiali: Dru i kualitetit të lartë kategoria A1 Mbushja: Fije minerale MAT, e tërë sipërfaqja e mbuluar me ngjites, izolimi termik bazuar ne rreguloren DIN 52619 ( $UT=1.3$ W / m <sup>2</sup> K), korniza standarde Dru 15-30 mm, shtresë standarde e bërë me super dekor, Super-Color, Super-Multi Color. Te Kompletohet me dorezë alumini me pllakëz për objekte publike dhe bagllama standarde për objekte publike. Verejtje: Masat per prodhim te merren ne vend!	cope	3.00	200.00	€	600.00	
3.6	Furnizimi me material, punimi dhe montimi i deres-griles metalike. Dera duhet te jete me dim. (210/100)cm. Korniza te punohet nga shufrat metalike me dim.(40x40x4)mm dhe mbushja me profile vertikale me dim.(20x20x2)mm dhe te larguara nga njera tjetra me distance (10-12)cm. Te kompletohet me dorezë alumini me pllakëz dhe bagllama standarde për dyer metalike. Dera metalike do te sherbej si gril per deren e plastikes ne hyrje te objektit. Ne cmim te kalkulohet edhe fiksimi i deres ne muire. Verejtje: Masat per prodhim te merren ne vend!	cope	3.00	270.00	€	810.00	
III	<b>TOTAL PUNET E ZDRUKHTARISE</b>					€	<b>3,170.00</b>
IV	<b>PUNIMET E NGJYROSJES, DYSHEMES DHE BANJOS</b>						
4.1	Suvatimi i MUREVE TË MBRENDSHME me llaç vazhdues ne dy shtresa dhe me sperkatje paraprake më lëng cimentoje. Ne cmim hyn edhe skela e nevojshme!	m <sup>2</sup>	660.00	0.10	€	66.00	
4.2	Furnizimi me material dhe permisimi i mureve dhe tavaneve me glet. Ne cmim te kalulohen edhe skelet e nevojshme.	m <sup>2</sup>	660.00	0.10	€	66.00	




4.3	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve dhe tavaneve (mbi glet) me ngjyrë. Ngjyra duhet të ipet në dy shtresa dhe para aplikimit të saj duhet të vendoset baza. Nuanca e ngjyres te caktohet nga organi mbikqyres. Ne cmim te llogariten edhe skelet e nevojshme. Llogaria në m².	m²	660.00	1.50	€	990.00
4.4	Grryerja e ngjyres ekzistuese qe eshte djegur, ne kete pozicion te parashihet furnizimi me material, gletimi dhe ngjyrosja e mureve dhe tavaneve me ngjyrë. Ngjyra duhet të ipet në dy shtresa dhe para aplikimit të saj duhet të vendoset baza. Nuanca e ngjyres te caktohet nga organi mbikqyres. Ne cmim te llogariten edhe skelet e nevojshme.	m²	215.00	0.10	€	21.50
4.5	Furnizimi transporti dhe punimi i shtresës rrafshuese "ESTRIH" në dyshemetë e objektit. Shtresa rrafshuese Estrih të punohet në trashësi T= 5 cm dhe e armuar me rrjetë "RABITS". Vendosja e termoizolimit mbi pllaken beton-arme "Styrodur N4" i presuar me c=2+3 cm duke vendosur folie plastike PVC mbi të. Sipërfaqja e estrihut duhet të ndahet me fugë dilatuese ose të pritët pas punimit.	m²	175.00	0.50	€	87.50
4.6	Furnizimi dhe montimi i laminatit AC-4 për administratë me trashësi 12cm, me të gjitha pjesët përcjellëse si dhe llajset perimetrike nga druri, laminati të jetë i kualitetit më të lartë, rezistent nga uji, oqjes, oqj. Llogaria në m².	m²	175.00	15.00	€	2,625.00
4.7	Furnizimi, transporti me material blloqe argjillore "GITER" apo ekujvalent dhe muratimi i mureve ndarëse të hapsirave të objektit në trashësi të mureve D=12 cm nga dyshemeja deri nën pllakën e meskatit. Muratimi të bëhet sipas standarde dhe sipas manualeve sipas tiptit të blloqeve me fuga horizontale dhe fuga vertikale. Muratimi me llaq vazhdues ose ngjithës adekuat sipas prodhuesit dhe manualeve. Ne llogari hyn edhe skela e nevojshme per muratim.	m²	14.50	14.00	€	203.00
4.8	Furnizimi me material dhe punimi i rrjetit te ujesjellesit Ø16mm nga kokat perfundimtare deri te kolektoret. Ne cmim te parashihen edhe te gjitha elemente tjera fazonike si dhe lidhja me rrjetin ekzistues te ujesjellesit.	m'	35.00	1.00	€	35.00
4.8	Furnizimi me material dhe punimi i rrjetit te kanalizimit. Ø110mm dhe Ø75mm deri tek dalja me e afert per shikarkim. Ne cmim te parashihen edhe te gjitha elemente tjera fazonike si dhe lidhja me rrjetin ekzistues te kanalizimit	m'	26.50	2.00	€	53.00
4.9	Furnizimi dhe punimi i hidroizolimit te ftoft dy komponent dy shtresor neper hapsirat ku do te vendosen pllakat.	m²	65.00	0.50	€	32.50
4.11	Furnizimi me material, mveshja e dyshemesë dhe mureve me pllaka keramike të klasit parë me llaq adekuat. Ngjyra dhe kualiteti i pllakave duhet të caktohet nga mbikqyrësi.	m²	97.60	13.50	€	1,317.60




4.12	Furnizimi, transporti dhe montimi i komplet paisjeve per lavaman të klasit të I-rë, duke përfshirë: baterija manuale për ujë të ftohtë dhe të ngrohtë komplet me dy "EK" valvula gypat fleksibil per furnizim te ujit, dhe te gjitha paisjet e tjera deri ne funksionalizim te plote te lavamanit. Ne çmim te kalkulohet edhe demontimi i paisjeve(aksesoreve) egzistues te cilat jane te demtuara. Llogaritja për copë të lavamanit të kompletuar	copë	2.00	65.00	€	130.00
4.13	Furnizimi, transporti dhe montimi i guacës së WC-së te tipit te rrafshite-turke prej porcelanit, po ashtu duhet të përfshihon të gjitha elementet e një WC guackës, me gypin e kanalizimit S, komplet me kazanin per uje , me gyp per shperlarje Ø 5/4" dhe manzhete te gomes, dihtung te gomes dhe vida te mesingut me tipla. Gjithashtu ne çmim duhet llogaruar edhe "EK" valvola per lidhje te kazanit si dhe nje krua per pastrim i cili me guacen e WC-se lidhet permes nje gypi te zinktuar me diameter Ø 3/8". Llogaritja për copë të komplet pozicionit të ekzekutuar.	copë	3.00	85.00	€	255.00
4.14	Furnizimi, transporti dhe montimi i setit te pasqyres, mjatesit te palomave neper hapsirat e nevojshme	cope	2.00	30.00	€	60.00
<b>IV</b>	<b>TOTAL PUNIMET E NGJYROSJES, DYSHEMES DHE BANJOS</b>				€	<b>5,942.10</b>

<b>A</b>	<b>ARKITEKTURA</b>				
I	PUNIMET E DEMOLIMI	€			312.35
II	PUNIMET E KONSTRUKSIONI MFSKA I FSH	€			755.00
III	PUNET E ZDRUKHTARISE	€			3,170.00
IV	PUNIMET E NGJYROSJES, DYSHEMES DHE BANJOS	€			5,942.10
	<b>TOTALI ARKITEKTURA</b>	€			<b>10,179.45</b>

<b>B</b>	<b>INSTALIMET ELEKTRIKE</b>				
<b>I</b>	<b>KUADROT</b>				
I.1	Kuadri elektrik sekondare KE-P cili permban:	cope			
	Fid 4p, 40 A/30mA	1			
	Sigures automatike 10A ,1p	10			
	Sigures automatike 16A ,1p	24			
	Komplet ky pozcion		1.00	150.00	€ 150.00
<b>I</b>	<b>TOTAL KUADROT</b>				€ <b>150.00</b>
<b>II</b>	<b>NDRIQESIT DHE SHPENZUESIT E TJERE</b>				
		Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
2.1	Furnizimi dhe montimi i trupit ndriques te tipit plafonjerk, per vendosje ne banjo dhe ballkone	cope	8.00	10.00	€ 80.00
2.2	Furnizimi dhe montimi i kabllit PPY 3x1.5mm per trupin ndriques te tipit Plafonjerk ne e banjo me gjatsi mesatare 15m. Paguhet per njesi	cope	8.00	5.00	€ 40.00
2.3	Furnizimi dhe montimi i trupit ndriques LED PANEL me dimensione 60x60 cm , 32 W per vendosje ne Zyre	cope	20.00	25.00	€ 500.00
2.4	Furnizimi dhe montimi i kabllit PPY 3x1.5mm per trupi ndriques LDE PANEL me gjatsi mesatare 15m. Paguhet per njesi	cope	20.00	5.00	€ 100.00
2.5	Furnizimi dhe montimi i trupit ndriques emergjent LED max 10VV me bateri, me autonomi i h pas nderprerjes se rrymes.	cope	8.00	10.00	€ 80.00





2.6	Furnizimi dhe montimi i kablilit PPY 3x1.5mm per trupin ndriqes emergjent me gjatsi mesatare 15 m. Paguhet per njesi	cope	8.00	5.00	€	40.00
2.7	Furnizimi dhe montimi i nderprersit te thjesht (njefishte) per ndriqim	cope	12.00	5.00	€	60.00
2.8	Furnizimi dhe montimi i kablilit PP Y 3x1.5 per nderprers me gjatsi mesatare 15m	cope	12.00	7.00	€	84.00
2.9	Furnizimi dhe montimi i prizave monofazore te njefishta 220V 16 A	cope	15.00	8.00	€	120.00
2.10	Furnizimi dhe montimi prizes se trefisht ne kutine modulare 7 modulesh ku perfshihen tri prizat njefazore dhe hapsira per prizat te internetit dhe telefonit	cope	10.00	8.50	€	85.00
2.11	Furnizimi dhe montimi i kablilit PPY 3x2.5mm per prizat monofaze me gjatsi mesatare 15 m , futet me tub mbrojtjes. Paguhet per njesi.	cope	25.00	5.00	€	125.00
2.12	Furnizimi dhe montimi gypit te brinjzuar ø 16	m'	400.00	0.02	€	8.00
2.13	Furnizimi dhe montimi gypit te brinjzuar ø 32	m'	100.00	0.04	€	4.00
2.14	Matorjali i imet i paparapara	cope	1.00	10.00	€	10.00
<b>II</b>	<b>TOTAL NDRIQESIT DHE SHPENZUESIT E TJERE</b>				€	<b>1,336.00</b>
<b>III</b>	<b>KABLOTT E FURNIZIMEVE</b>					
3.1	Furnizimi dhe shtrirja e kabllit NYY-J 5x6mm nga KSHEK deri te kuadri sekonare, KE-P	m'	100.00	1.90	€	190.00
<b>III</b>	<b>TOTAL KABLOTT E FURNIZIMEVE</b>				€	<b>190.00</b>
<b>IV</b>	<b>RRYMAT E DOBETA</b>					
4.1	Furnizimi dhe montimi i kabllit UTP per internet , telefon dhe interfon	m'	450.00	0.30	€	135.00
4.2	Furnizimi dhe montimi i prizave te internetit	cope	15.00	12.00	€	180.00
4.3	Furnizimi dhe montimi i prizave te telefonit	cope	15.00	12.00	€	180.00
4.4	Material i imet	cope	1.00	10.00	€	10.00
<b>IV</b>	<b>TOTAL RRYMAT E DOBETA</b>				€	<b>505.00</b>
<b>B</b>	<b>INSTALIMET ELEKTRIKE</b>					
<b>I</b>	<b>KUADROT ELEKTRIK</b>				€	<b>150.00</b>
<b>II</b>	<b>NDRIQESIT DHE SHPENZUES TJERE</b>				€	<b>1,336.00</b>
<b>III</b>	<b>KABLOTT E FURNIZIMEVE</b>				€	<b>190.00</b>
<b>IV</b>	<b>RRYMAT E DOBETA</b>				€	<b>505.00</b>
	<b>TOTALI INSTALIMET ELEKTRIKE</b>					<b>2,181.00</b>



RIKAPITULLIMI		
A	ARKITEKTURA	€ 10,179.45
B	INSTALIMET ELEKTRIKE	€ 2,181.00
<b>TOTALI</b>		<b>€ 12,360.45</b>

Emri i Kompanisë	"INTACT" SHPK
Adresa e Plote	Rr.Saraçovo PN, Prizren
Përfaqësuar Nga:	
Emri & Mbiemri	Dardan Iseni
Pozita	Drejtor
Nënshkrimi	<i>D Iseni</i>
Data	08.00.2020
Vula	






AFATI KOHOR ( fillimi – përfundimi i projektit )

**Titulli: Renovimi Hapsirave të brendshme në Objektivin e Qendres Rinore**


Nr i prokurimit	617-20-4767-5-2-1
Nr i brendshëm	617-2020-059-521

Sipas pikës 5.2 D.T.: fillim **21.09.2020** përfundim **21.12.2020**



e-mail: [intactshpk@gmail.com](mailto:intactshpk@gmail.com)

Adresa: rr. Saraçevë pn. Prizren




**PLANI DINAMIK**

Titulli i kontratës: Renovimi Hapsirave te brendshme ne Objektin e Qenderes Rinore


Nr. i Prokurimit: 617-20-4767-5-2-1

		TETOR																													
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
	Afatet kohore 52 ditë pune NR I DITËVE	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
	Renovimi Hapsirave te brendshme ne Objektin e Qenderes Rinore	DATA 30	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29
	Afatet kohore 52 ditë pune NR I DITËVE	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	56	57	58	59	60
1	Renovimi Hapsirave te brendshme ne Objektin e Qenderes Rinore	DATA 31	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29
	Afatet kohore 52 ditë pune NR I DITËVE	61	62	63	64	65	66	67	68	69	70	71	72																		
1	Renovimi Hapsirave te brendshme ne Objektin e Qenderes Rinore	DATA 30	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11																		
VEREJTJE AFATI KOHOR PER: Renovimi Hapsirave te brendshme ne Objektin e Qenderes Rinore ,		ËSHITË 52 DITË PUNE																													

DITE PUNE  
DITE VIKENDI



PRIZREN: 30.09.2020





# ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Deklarata e garantuesit

Gjithcka që duhet ta kenë

## Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 87319

Për **KOMUNA SHTIME**

( Emri i "Autoritetit Kontraktues" )

Në emër të **INTACT SH.P.K.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Renovimi Hapsirave të brendshme në Objektin e Qenderes Rinore**

Nr. prokurimit: 617-20-4767-5-2-1 , Nr. brendshëm: 617-2020-059-521

### Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues,

dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **1,236.10€** zotohem të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **1,236.10€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 113 ditë kalendarike prej **30.09.2020** deri më **21.01.2021**

Data lëshimit: 30.09.2020

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit

Da Sulco



Nr i Serisë

**0055447**